

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: Autoriteti Qendror i Prokurimit

Për Aktivitetin e Prokurimit: "Furnizim me karburante
Nr i Prokurimit: 201/26300-26-2068-1-1-1E

ANKESË

Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK: Grupi i OE: "LAB OIL" Sh.p.k & N.T "Fer Petroll"
Sh.p.k

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Granic-Magjistralla Prishtin Shkup-Preoc
Drenas – Terstenik/ Rr Shaban Polluzha, pn,

(Adresa)

Graçanicë

105000

Prishtinë

380000

(Vendi)

(Kodi postar)

(Numri Telefonit)

Raif Gashi- "LAB OIL" Sh.p.k

Mehdi Gjoka - N.T "Fer Petroll" Sh.p.k

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

(Numri i Faks-it)

Adresa elektronike)

info@laboil-ks.com

12.08.2026

(Data e parashtrimit të Ankesës)

1. "LAB OIL" Sh.p.k

2.. N.T "Fer Petroll" Sh.p.k

2. Identifikimi i avokatit

(Nënshkrimi dhe vula)

B. / 1597



Parashtruesi i Ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.
Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Adresa elektronike)

(Numri i faks-it)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftim për Kontratë me dt 17.04.2026

B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara me 20.05.2026, 08.06.2026

Hapja e ofertave është bërë me dt 11.06.2026

Njoftimi mbi Vendimin me letra standarte 21.07.2026

Kërkesa për Rishqyrtim 27.07.2026

Përgjigjeje ndaj kërkesës për rishqyrtim 03.08.2026

Kriteret e Dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me çmim me të lirë,

Duke u bazuar në Njoftimin për Kontratë (NJK) dhe Dosjen e Tenderit (DT), konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP), gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe me dispozitat e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Në këtë drejtim, konsiderojmë se janë cenuar qëllimet dhe parimet themelore të përcaktuara me LPP, përkatësisht:

Neni 1 i LPP-së, i cili përcakton qëllimin e ligjit për sigurimin e një mënyre sa më efikase, transparente dhe të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike;

Neni 2 i LPP-së, lidhur me fushëveprimin dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji;

Neni 6 i LPP-së, i cili përcakton parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik;

Neni 7 i LPP-së, i cili obligon Autoritetin Kontraktues të sigurojë trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim të operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar në mënyrë të plotë kërkesat e përcaktuara me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, përfshirë dispozitat e nenit 4.3, sipas të cilave Zyra e Prokurimit ka obligim që gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi dhe për të shmangur çdo veprim që mund të rezultojë me shkelje të dispozitave të LPP-së.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që procesin e vlerësimit ta zhvillojë në mënyrë objektive, transparente dhe të barabartë, duke u mbështetur vetëm në kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, pa aplikuar kritere apo interpretime shtesë që nuk kanë qenë të parapara paraprakisht.

Qëllimi i Ligjit për Prokurimin Publik është që të sigurojë shfrytëzimin më efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike, duke garantuar konkurrencë të ndershme ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe duke siguruar që oferta më e favorshme, e cila përmbush kërkesat e tenderit, të trajtohet në mënyrë të barabartë dhe të drejtë.

Për këtë arsye, vlerësojmë se mënyra e veprimit të Autoritetit Kontraktues në këtë procedurë ka cenuar parimet themelore të prokurimit publik dhe ka ndikuar në një proces vlerësimi jo të barabartë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☒

Jo

☐

Procedura ende është në fazën publikimit të tenderit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit

Po

☒

Jo

☐**6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së / Qëllimi

Neni 2 i LPP-së / Fushëveprimi

Neni 6 i LPP-së / Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 i LPP-së / Barazia në trajnim / Jo – Diskriminim

Neni 59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 i LPP-së / Kriteret për dhënien e kontratës

Neni 64 i LPP-së / Dëshmitë e kërkesave

Neni 66 i LPP-së / Përshtatshmëria Profesionale

**RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E
RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK**

Neni 26/ Grupi i Operatorëve Ekonomik

Neni 40/ Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshtetja rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Furnizim me karburante”, Nr i Prokurimit: 201/26300-26-2068-1-1-1

Grupi i OE “LAB OIL” Sh.p.k & N.T “Fer Petroll” Sh.p.k janë palë me interes në aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me karburante”, ka aplikuar në dy Lote

Lote të kontestuara:

Lot 4 – Furnizim me karburant për nxemje, gjenerator dhe rezerva për nevojat e institucioneve publike në nivel qendror

Vlera e ofertës së Grupit të OE “LAB OIL” Sh.p.k. & N.T “Fer Petroll” Sh.p.k.: 3,588,731.56 €

Lot 9 – Furnizim me karburant për Rajonin e Mitrovicës (Nivel Lokal)

Vlera e ofertës së Grupit të OE “LAB OIL” Sh.p.k. & N.T “Fer Petroll” Sh.p.k.: 696,725.12 €

Në bazë të ofertave financiare të dorëzuara në platformën elektronike **e-Prokurimi**, **Grupi i OE “LAB OIL” Sh.p.k & N.T “Fer Petroll” Sh.p.k** ka qenë ofertuesi me çmimin më të ulët ekonomikisht për të dy lotet e lartcekura.

Përkundër faktit se oferta jonë ka qenë me çmim më të lirë dhe ka pas parasysh përdorimin më efikas të mjeteve publike, Autoriteti Kontraktues, me datë **21.07.2026**, përmes sistemit elektronik **e-Prokurimi**, na ka njoftuar me: **Njoftimin mbi Vendimin** duke na eliminuar si **Grup i OE i papërgjegjshëm**, me arsyetimin se nuk kemi përmbushur kërkesën e Dosjes së Tenderit.

ARSYETIMI I ELIMINIMIT TË OFERTËS SONË Grupi i OE “LAB OIL” Sh.p.k & N.T “Fer Petroll” Sh.p.k

Arsyeja e eliminimit sipas AK-AQP-së, ka qenë mosplotësimi i **Kërkesës 4**: “Garancion apo autorizim apo konfirmim nga rafineria/prodhuesi.”

Evidencës 4: “Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhuesi – rafineria, që garanton se do të furnizojë për kontratën/lotin e specifikuar në të cilin oferton – origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur.”

Pas tërheqjes dhe analizimit të dokumentacionit të tenderit në platformën elektronike **e-Prokurimi**, kemi konstatuar se vendimarrja e Autoritetit Kontraktues është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Rregullores Nr. 002/2024, si dhe me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumentacionit të Operatorit Ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës, kemi konstatuar se dokumentet e paraqitura nga ky operator nuk përmbushin të njëjtën kërkesë të Dosjes së Tenderit. Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues e ka konsideruar ofertën e tij të përgjegjshme dhe e ka rekomanduar për dhënie të kontratës, duke përdorur standarde të ndryshme gjatë procesit të vlerësimit.

KUNDËRSHTIMI VENDIMIT MBI NJOFTIMIN E AK AQP-së

Kundërshtojmë në tërësi këtë vendim, pasi konsiderojmë se i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e **Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës**, i ndryshuar dhe plotësuar me **Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**, si dhe me dispozitat e **Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, si dhe me parimet themelore të prokurimit publik, përkatësisht parimin e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, transparencës dhe përdorimit efikas të fondeve publike.

Nga arsyetimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktues rezulton se oferta jonë është eliminuar me arsyetimin se mungon **Garancioni/Autorizimi nga prodhuesi**. Mirëpo, pas analizimit të dokumentacionit të procedurës, kemi konstatuar se Autoriteti Kontraktues – AQP nuk ka aplikuar të njëjtin standard vlerësimi ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë, por ka përdorur **standarde të ndryshme dhe të pabarabarta** gjatë shqyrtimit të ofertave.

Në rastin tonë, Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se dokumentacioni i paraqitur nuk është i mjaftueshëm për përmbushjen e kërkesës së Dosjes së Tenderit, ndërsa në anën tjetër ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik **“Petrol Company” Sh.P.K.**, ndonëse dokumenti i paraqitur nga ky operator nuk përbën garancion apo autorizim në kuptimin e kërkesës së Dosjes së Tenderit. Konkretisht, operatori ekonomik **“Petrol Company” Sh.P.K.** ka paraqitur dokumentin e lëshuar nga **OKTA AD – Shkup**, me titull **“Supply Contract with Manufacturer”**. Nga përmbajtja e këtij dokumenti rezulton se bëhet fjalë për një marrëveshje furnizimi ndërmjet palëve dhe jo për një **Garancion të prodhuesit** apo **Autorizim të prodhuesit**, siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në dokumentet e tenderit.

Ky dokument nuk përmban një deklaram të qartë të prodhuesit për autorizimin e operatorit ekonomik për këtë procedurë prokurimi dhe nuk ofron garanci të drejtpërdrejtë lidhur me përgjegjësinë e prodhuesit për furnizimin, cilësinë dhe vazhdimësinë e furnizimit gjatë realizimit të kontratës.

Në anën tjetër, Grupi i Operatorëve Ekonomik **“LAB OIL” Sh.p.k. & N.T “Fer Petroll” Sh.p.k.** ka paraqitur dokumentacion që dëshmon marrëdhënie të rregullt furnizimi përmes marrëveshjes me kompaninë **“Kastrati Group” SH.A.**, e cila është distributor i autorizuar i prodhuesit **BP Oil International Limited**, me seli në Angli. Ky dokumentacion siguron Autoritetin Kontraktues se ekziston një zinxhir i furnizimit dhe se mundësohet furnizimi i sigurt, i vazhdueshëm dhe sipas kërkesave të kontratës.

Prandaj, edhe nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur paqartësi lidhur me interpretimin e dokumenteve të paraqitura nga Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë, ai ka qenë i obliguar që të zbatojë të njëjtin standard edhe ndaj operatorit ekonomik të rekomanduar. Nuk është e lejueshme që një operator ekonomik të eliminohet për shkak të një interpretimi të caktuar të dokumentacionit, ndërsa një operator tjetër të pranohet me dokumentacion që në thelb nuk e përmbush kërkesën e njëjtë.

Një veprim i tillë është në kundërshtim me **nenin 7 të LPP-së**, i cili obligon Autoritetin Kontraktues që të sigurojë trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim të të gjithë operatorëve ekonomikë gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Po ashtu, bie në kundërshtim me **nenin 56 të LPP-së**, pasi vlerësimi dhe eliminimi i ofertave duhet të bëhet vetëm mbi bazën e kërkesave të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk mund të interpretojë ose të krijojë kërkesa të reja gjatë fazës së vlerësimit, të cilat nuk kanë qenë të përcaktuara qartë në dokumentet e tenderit.

Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues ka aplikuar një qasje më të ashpër ndaj ofertës sonë, ndërsa ka pranuar dokumentacion më pak të përcaktuar nga operatori ekonomik i rekomanduar, duke cenuar kështu parimin e konkurrencës së drejtë dhe të trajtimit të barabartë.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të ketë në konsideratë faktin se oferta jonë është oferta ekonomikisht më e favorshme për **Lotin 4 dhe Lotin 9**, me një diferencë të përgjithshme prej **122,099.47 €** më të ulët krahasuar me ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar.

Duke eliminuar ofertën tonë, e cila përveç se është ekonomikisht më e favorshme, ka paraqitur dokumentacion që garanton furnizimin për realizimin e kontratës, Autoriteti Kontraktues ka rrezikuar cenimin e parimit të përdorimit racional dhe efikas të fondeve publike.

Në kuptim të dispozitave të **nenit 40 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, përkatësisht paragrafëve **40.2, 40.6, 40.12 dhe 40.13**, Autoriteti Kontraktues ka obligim që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ta bëjë në mënyrë objektive, transparente dhe duke zbatuar kriteret e publikuara në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Bazuar në të gjitha këto fakte dhe argumente juridike, konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës sonë dhe rekomandimin e operatorit ekonomik **"Petroll Company" Sh.P.K.** është i pabazuar në dispozitat ligjore dhe në kërkesat e Dosjes së Tenderit.

DËMI EKONOMIK DHE CENIMI I PARIMIT TË EKONOMICITETIT

Grupi i OE "LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k. ka paraqitur ofertën me çmimin më të lirë në krahasim me Operatorin Ekonomik **"Petrol Company" SH.P.K.**, i rekomanduar për shpërblim me kontratë.

Dallimi financiar ndërmjet ofertave është:

Lot 4. Diferenca ndërmjet ofertës së Grupit të OE: **"LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k.** dhe ofertës së OE: **"Petrol Company" H.P.K.** është: **109,032.00 €** më e lartë oferta e OE "Petrol Company" SH.P.K.

Lot 9. Diferenca ndërmjet ofertës së Grupit të OE: **"LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k.** dhe ofertës së OE: **"Petrol Company" SH.P.K.** është: **13,067.47 €** më e lartë oferta e OE "Petrol Company" SH.P.K.

Pra, në total, rekomandimi i OE "Petrol Company" SH.P.K. paraqet një kosto shtesë për Autoritetin Kontraktues prej: **122,099.47 €**

Nga analiza e ofertave financiare rezulton se Grupi **"LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k.** ka paraqitur ofertën me çmimin më të ulët ekonomikisht për të dy lotet.

Përkundër këtij fakti, Autoriteti Kontraktues ka eliminuar ofertën tonë dhe ka rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik: **"Petrol Company" SH.P.K.**

Për te qen me e qartë AK ka anashkalluar drejtpërdrejt: parimin e ekonomicitetit, përdorimin efikas të fondeve publike, mbrojtjen e interesit publik.

KËRKESA E KONTSTUAR NË DOSJEN E TENDERIT

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar kërkesën si vijon:

Kërkesa 4: **"Garancion apo autorizim apo konfirmim nga rafineria/prodhuesi."**

Evidenca 4: **"Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhuesi – rafineria, që garanton se do të furnizojë për kontratën/lotin e specifikuar në të cilin ofertoni – origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur."**

Kjo kërkesë është vendosur nga vetë Autoriteti Kontraktues me qëllim të sigurimit se operatori ekonomik do të ketë mbështetje reale nga prodhuesi/rafineria dhe se furnizimi për kontratën përkatëse do të jetë i garantuar.

Prandaj kjo kërkesë nuk ka qenë thjesht dokument formal, por kriter substancial që lidhet drejtpërdrejt me realizimin e kontratës

ANALIZA E DOKUMENTACIONIT TË PARAQITUR NGA OE I REKOMANDUAR "PETROL COMPANY" SH.P.K.

Operatori Ekonomik **"Petrol Company" SH.P.K.** ka paraqitur dokumente të lëshuara nga OKTA AD – Shkup, të titulluara: **"Supply Contract with Manufacturer"**

Nga analiza e përmbajtjes së këtyre dokumenteve rezulton se ato nuk përmbushin kërkesën e Dosjes së Tenderit.

1. Dokumenti i paraqitur nuk përbën autorizim nga prodhuesi

Në dokumentet e paraqitura nuk ekziston asnjë deklaratë e qartë me të cilën OKTA, autorizon Petrol Company për këtë aktivitet të prokurimit, nuk autorizon Petrol Company për furnizimin e Autoritetit Kontraktues, nuk garanton furnizimin për kontratën konkrete i cili është objekt i këtij aktiviteti.

Në dokument thuhet: **"...a valid supply contract is in effect with Petrol Company..."**

Kjo deklaratë vetëm konfirmon ekzistencën e një kontrate furnizimi ndërmjet OKTA dhe Petrol Company. Në vetvete, ajo nuk konfirmon se produktet e furnizuara janë prodhuar apo rafinuar nga OKTA. Për më tepër, nga informacionet publike të disponueshme rezulton sipas historikut zyrtar të vetë kompanisë OKTA, në janar të vitit 2013 rafineria ndërpreu procesin e prodhimit dhe kompania filloi transformimin në një kompani logjistike dhe tregtare, e fokusuar në magazinimin, transportin dhe furnizimin me derivate të naftës. Për rrjedhojë, ekzistenca e një kontrate furnizimi nuk mund të interpretohet si provë se OKTA është prodhuese e produkteve të naftës, por vetëm se ajo vepron si furnizuese ose ndërmjetëse në zinxhirin e furnizimit. Një kontratë furnizimi nuk është e njëjtë me autorizim nga prodhuesi, garancion nga prodhuesi, konfirmim nga prodhuesi që garanton furnizimin për kontratën specifike. Autoritetit Kontraktues nuk ka kërkuar thjesht dëshmi për ekzistencën e një kontrate tregtare, por ka kërkuar dokument që garanton furnizimin nga prodhuesi/rafineria.

2. Dokumenti i OKTA-s e identifikon aktivitetin si tregtar me shumicë

Në dokumentin e paraqitur nga OKTA thuhet: **"OKTA Crude Oil Refinery Shareholding Company..., wholesale trader of fuel derivatives..."**

Pra, dokumenti vetë e identifikon OKTA-n si: **"wholesale trader of fuel derivatives"** apo tregtar me shumicë i derivateve të naftës.

Në asnjë pjesë të dokumentit nuk ekziston deklaratë e qartë se OKTA është prodhuesi i produkteve që janë objekt i furnizimit sipas kësaj procedure.

3. Dokumenti vetë identifikon HELLENiQ ENERGY Greece si prodhues

Në faqen e dytë të dokumentit thuhet: **"The Client is currently supplied by OKTA with oil derivatives manufactured by HELLENiQ ENERGY Greece."**

Nga kjo deklaratë rezulton se: produktet furnizohen përmes OKTA-s, por produktet janë të prodhuara nga HELLENiQ ENERGY Greece.

Pra, vetë dokumenti identifikon një subjekt tjetër si prodhues të derivateve.

Për rrjedhojë, dokumentet e paraqitura nga OE i rekomanduar nuk dëshmojnë se konfirmimi është lëshuar nga prodhuesi i produkteve objekt i furnizimit, siç kërkohet në Dosjen e Tenderit.

4. Dokumenti nuk garanton furnizimin për kontratën objekt të tenderit

Është shqetësuese fakti se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar këtë dokument pikërisht për të siguruar furnizimin e kontratës, ndërsa dokumentet e paraqitura nga OE i rekomanduar nuk përmbajnë një garanci të tillë.

Në dokument thuhet: **"OKTA expressly states that the aforementioned contract is not exclusive."**

Pra, vetë dokumenti deklaron se kontrata nuk është ekskluzive.

Gjithashtu thuhet: **"OKTA assumes no responsibility for the quality or quantity delivered by Petrol Company."**

Me këtë deklaratë OKTA përcakton se: nuk merr përgjegjësi për sasinë e furnizimit, nuk merr përgjegjësi për cilësinë e produkteve dhe nuk merr përgjegjësi për furnizimin që Petrol Company do t'ia bëjë Autoritetit Kontraktues.

Kjo është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me qëllimin e kërkesës së Autoritetit Kontraktues, e cila kërkonte: **garancion, autorizim apo konfirmim nga prodhuesi/rafineria që garanton furnizimin për kontratën.**

Lidhur me dokumentacionin e paraqitur nga OKTA – Shkup dhe natyrën juridike të tij

Një fakt shtesë që e forcon edhe më shumë pretendimin tonë lidhur me mosplotësimin e kërkesës për **Autorizim nga Prodhuesi** është se, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të procedurës, rezulton se **dy operatorë ekonomikë të ndryshëm, të cilët kanë ofertuar për lote të ndryshme në këtë aktivitet të prokurimit, kanë paraqitur dokumentacion të lëshuar nga i njëjti subjekt – OKTA AD Shkup, me përmbajtje të ngjashme/të njëjtë të titulluar "Supply Contract with Manufacturer"**.

Ky fakt ngre dyshime të arsyeshme lidhur me natyrën juridike të këtij dokumenti, pasi një dokument i tillë, i cili paraqitet si dëshmi e autorizimit nga prodhuesi, nuk përcakton në mënyrë të qartë se cili operator ekonomik është i autorizuar, në çfarë cilësie, për cilin aktivitet prokurimi dhe me çfarë përgjegjësie konkrete të prodhuesit për furnizimin dhe realizimin e kontratës.

Një **Autorizim nga Prodhuesi**, për nga natyra e tij juridike, duhet të jetë një dokument individual dhe i qartë, i cili identifikon përfituesin e autorizimit, objektin e autorizimit, të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve, si dhe lidhjen konkrete ndërmjet prodhuesit dhe operatorit ekonomik që paraqet ofertën.

Fakti që i njëjti lloj dokumenti nga i njëjti subjekt (**OKTA AD – Shkup**) është përdorur nga më shumë se një operator ekonomik ("Petrol Company" Sh.p.k dhe EX FIS Sh.P.K nga i njëjti Furnizues jo Autorizues)

në të njëjtën procedurë prokurimi, për lote të ndryshme, tregon se ky dokument më shumë paraqet një marrëdhënie të përgjithshme tregtare/furnizimi ndërmjet palëve dhe jo një **autorizim specifik të prodhuesit**, siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit. Për më tepër, nëse Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se dokumenti i paraqitur nga Grupi i Operatorëve Ekonomik **“LAB OIL” Sh.p.k. & N.T “Fer Petroll” Sh.p.k.** nuk përbën autorizim të vlefshëm nga prodhuesi, atëherë i njëjti standard vlerësimi është dashur të zbatohet edhe ndaj operatorëve të tjerë ekonomikë që kanë paraqitur dokument të së njëjtës natyre nga i njëjti subjekt.

SHKELJET E LIGJIT PËR PROKURIMIN PUBLIK

Shkelja e Nenit 1 të LPP-së

Neni 1 i LPP-së përcakton qëllimin e ligjit, përkatësisht sigurimin e: transparencës, konkurrencës së drejtë, trajtimit të barabartë, përdorimit efikas të fondeve publike. Në rastin konkret këto parime janë cenuar, pasi Autoriteti Kontraktues ka zbatuar standarde të ndryshme për operatorët ekonomikë gjatë vlerësimit.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së

Neni 7 i LPP-së obligon Autoritetin Kontraktues që: të trajtojë të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë, të mos diskriminojë operatorët ekonomikë, të zhvillojë procedurën në mënyrë transparente. Në rastin konkret: oferta jonë është eliminuar për mungesë të dokumentit nga prodhuesi-rafineria, ndërsa OE i rekomanduar është shpallur i përgjegjshëm edhe pse dokumentet e tij nuk dëshmojnë përmbushjen e së njëjtës kërkesë. Ky veprim përbën trajtim të pabarabartë.

Shkelja e Nenit 59 të LPP-së

Neni 59 i LPP-së obligon Autoritetin Kontraktues që: të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit, të zbatojë të njëjtat kritere për të gjithë operatorët ekonomikë. Nëse dokumentet e OKTA-s janë konsideruar të mjaftueshme për OE "Petroll Company", atëherë i njëjti standard është dashur të zbatohet edhe për ofertën tonë. Nëse ato dokumente nuk përmbushin kërkesën e Dosjes së Tenderit, atëherë edhe oferta e OE të rekomanduar është dashur të konsiderohet e papërgjegjshme.

Shkelja e Nenit 64 të LPP-së – Dëshmitë e Kërkesave

Neni 64 i LPP-së lidhet me obligimin e operatorëve ekonomikë për të paraqitur dëshmi që provojnë përmbushjen e kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Në këtë rast, kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë e qartë: Dokument nga prodhuesi – rafineria që garanton furnizimin për kontratën konkrete. Dokumentet e paraqitura nga OE “Petroll Company” SH.P.K. nuk provojnë këtë fakt. Ato vetëm dëshmojnë ekzistencën e një marrëdhënieje furnizimi ndërmjet OKTA-s dhe Petrol Company, por nuk dëshmojnë autorizim nga prodhuesi, garanci nga prodhuesi, konfirmim nga prodhuesi për furnizimin e kësaj kontrate.

Shkelja e Nenit 66 të LPP-së – Përshtatshmëria Profesionale

Neni 66 i LPP-së kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë përshtatshmërinë profesionale dhe aftësinë për realizimin e kontratës. Kërkesa për dokument nga prodhuesi/rafineria është vendosur pikërisht për të siguruar se operatori ekonomik ka burim të qëndrueshëm dhe të besueshëm furnizimi. Dokumentet e OE “Petroll Company” SH.P.K. nuk ofrojnë një siguri të tillë, pasi vetë OKTA: nuk garanton sasinë, nuk garanton cilësinë, nuk merr përgjegjësi për furnizimin.

SHKELJA E RREGULLORES NR. 001/2022 DHE NR. 002/2024

Autoriteti Kontraktues, sipas dispozitave të rregulloreve për prokurimin publik, është i obliguar që: të zbatojë kërkesat e Dosjes së Tenderit ashtu siç janë publikuar, të mos ndryshojë interpretimin e kriterëve pas hapjes së ofertave, të sigurojë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë, vendimet t'i bazojë vetëm në dokumentacionin e dorëzuar.

Në rastin konkret, kërkesa ka qenë e qartë: **Dokument nga prodhuesi – rafineria që garanton furnizimin.** Ndërsa është pranuar dokument i cili: identifikohet si dokument furnizimi, identifikon HELLENiQ ENERGY Greece si prodhues; nuk përmban garanci për furnizim, përjashton përgjegjësinë për cilësinë dhe sasinë.

Prandaj, dokumentet e paraqitura nuk përmbushin kërkesën e Dosjes së Tenderit.

KUNDËRSHTIM NDAJ VENDIMIT TË AK-AQP-SË PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM

Grupi i Operatorëve Ekonomikë "LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k., e kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues – AQP për refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim, pasi konsideron se përgjigjja e dhënë nga AK-AQP nuk i ka adresuar në mënyrë konkrete dhe të argumentuar pretendimet kryesore të ngritura në kërkesën tonë.

Në veçanti, AK-AQP nuk ka dhënë përgjigje konkrete lidhur me pretendimin tonë se dokumenti i paraqitur nga OE i rekomanduar, i lëshuar nga OKTA, nuk përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit për garancion, autorizim apo konfirmim nga prodhuesi/rafineria që garanton furnizimin për kontratën/lotin specifik.

Mbi arsyetimin e ak-aqp-së se okta është pjesë e grupit HELLENiQ ENERGY AK-AQP, në përgjigjen e saj, arsyetohet se:

"Konfirmimi nga OKTA është pranuar pasi që OKTA është pjesë e grupit HELLENiQ ENERGY që është prodhues i karburanteve."

Ky arsyetim nuk është i mjaftueshëm për të dëshmuar përmbushjen e kërkesës së Dosjes së Tenderit.

Kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë e përcaktuar në mënyrë të qartë:

"Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhuesi – rafineria, që garanton se do të furnizojë për kontratën/lotin e specifikuar në të cilin ofertoni – origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur."

Nga përmbajtja e kësaj kërkesë rezulton qartë se AK ka kërkuar jo thjesht dëshmi për ekzistimin e një marrëdhënieje tregtare, por një dokument që: vjen nga prodhuesi/rafineria që është garancion, autorizim ose **konfirmim** dhe garanton furnizimin për kontratën/lotin specifik.

Prandaj, gjatë vlerësimit AK-AQP ka qenë e obliguar të shqyrtojë përmbajtjen konkrete të dokumentit të paraqitur dhe jo vetëm marrëdhënien ndërmjet OKTA-s dhe HELLENiQ ENERGY.

Fakti që OKTA është pjesë e grupit HELLENiQ ENERGY nuk do të thotë automatikisht se çdo dokument i lëshuar nga OKTA përbën dokument të prodhuesit, në kuptim të kërkesës së Dosjes së Tenderit.

Në rastin konkret ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet subjektit që e ka lëshuar dokumentin dhe subjektit që në vetë dokumentin identifikohet si prodhues.

Dokumentit i paraqitur nga OE i rekomanduar është lëshuar nga OKTA, ndërsa në përmbajtjen e tij përmendet HELLENiQ ENERGY Greece si subjekt që ka prodhuar produktet.

Për këtë arsye, AK-AQP ka qenë e obliguar të sqarojë se mbi çfarë baze e ka konsideruar dokumentin e OKTA-s si "garancion, autorizim apo konfirmim nga prodhuesi – rafineria", kur vetë dokumenti identifikon një subjekt tjetër si prodhues.

Nëse sipas AK-AQP-së HELLENiQ ENERGY është prodhuesi/rafineria, atëherë duhet të ekzistojë në dokumentacion një deklaram, autorizim, konfirmim apo garancion nga ky prodhues që lidhet me furnizimin e kontratës/lotit konkret.

Përkatësia e OKTA-s në të njëjtin grup nuk mund të zëvendësojë dokumentin e kërkuar nga prodhuesi, nëse një mundësi e tillë nuk është paraparë në Dosjen e Tenderit.

Për më tepër, vetë përmbajtja e dokumentit të paraqitur nga OE i rekomanduar kërkon vëmendje të veçantë.

Sipas dokumentit, produktet identifikohen si të prodhuara nga HELLENiQ ENERGY Greece, ndërsa OKTA paraqitet në marrëdhënien e furnizimit me OE-në e rekomanduar.

Më e rëndësishmja, dokumenti përmban deklaram se:

"OKTA assumes no responsibility for the quality or quantity delivered by Petrol Company."

Ky deklaram është në kundërshtim me natyrën e kërkesës së përcaktuar nga AK në Dosjen e Tenderit, e cila kërkon dokument që "garanton se do të furnizojë për kontratën/lotin e specifikuar".

Nëse subjekti që lëshon dokumentin shprehimisht nuk merr përgjegjësi për cilësinë dhe sasinë e furnizimit, atëherë AK-AQP ka qenë e obliguar të shpjegojë se si një dokument i tillë është konsideruar si garancion apo konfirmim që garanton furnizimin për kontratën/lotin konkret.

Ky pretendim konkret i yni nuk është adresuar në mënyrë të arsyetuar në përgjigjen e AK-AQP-së.

Në rastin e Grupit tonë të Operatorëve Ekonomikë, AK-AQP ka zbatuar një interpretim strikt të kërkesës së Dosjes së Tenderit dhe ka konsideruar se dokumentacioni i dorëzuar nga ne nuk përmbush kërkesën për dokument nga prodhuesi/rafineria.

Në anën tjetër, ndaj OE të rekomanduar është pranuar dokumentacioni i lëshuar nga OKTA, mbi bazën e arsyetimit se OKTA është pjesë e grupit HELLENiQ ENERGY.

Kjo paraqet një standard të ndryshëm të vlerësimit të së njëjtës kërkesë.

Sipas nenit 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022, ofertat duhet të shqyrtohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. Rrjedhimisht, kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit duhet të zbatohen në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Në rastin konkret, AK-AQP nuk mund të kërkojë nga një operator ekonomik dokument të drejtpërdrejtë nga prodhuesi/rafineria, ndërsa për një operator tjetër ta konsiderojë të mjaftueshëm një dokument të lëshuar nga një subjekt tjetër vetëm për shkak të lidhjes së tij korporative me grupin e prodhuesit.

Nëse standardi i zbatuar ndaj Grupit tonë ka qenë se dokumenti duhet të jetë nga prodhuesi/rafineria, atëherë i njëjti standard është dashur të zbatohet edhe ndaj OE të rekomanduar.

Një element shtesë që duhet të merret në konsideratë është fakti se në Njoftimin për Kontratë Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar se variantet nuk lejohen.

Në këtë kontekst, pranimi i një mënyre alternative për përmbushjen e kërkesës së Dosjes së Tenderit nuk mund të justifikohet vetëm me faktin se subjekti që ka lëshuar dokumentin është pjesë e një grupi ku bën pjesë prodhuesi.

Nëse Dosja e Tenderit ka kërkuar dokument nga prodhuesi/rafineria, atëherë gjatë vlerësimit duhet të verifikohet përmbushja e kësaj kërkesë pikërisht sipas përmbajtjes dhe formës së kërkuar, dhe jo të pranohet një dokument i një subjekti tjetër si ekuivalent, pa një bazë të qartë në dokumentet e tenderit.

Për këtë arsye, edhe fakti se variantet nuk janë lejuar e përforcon nevojën që kërkesat e Dosjes së Tenderit të zbatohen ashtu siç janë publikuar dhe në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Nga sa më sipër rezulton se AK-AQP nuk ka dhënë përgjigje konkrete dhe të argumentuar ndaj pretendimit tonë kryesor, por ka arsyetuar pranimin e dokumentit të OKTA-s vetëm me faktin se kjo kompani është pjesë e grupit HELLENiQ ENERGY.

Ky fakt, në vete, nuk dëshmon se dokumenti i paraqitur përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit për: “Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhuesi – rafineria, që garanton se do të furnizojë për kontratën/lotin e specifikuar...”

Për më tepër, vetë dokumenti identifikon HELLENiQ ENERGY Greece si prodhues të produkteve, ndërsa dokumenti është lëshuar nga OKTA dhe përmban deklarin se OKTA nuk merr përgjegjësi për cilësinë dhe sasinë e produkteve të dorëzuara nga OE i rekomanduar.

Për rrjedhojë, AK-AQP ka qenë e obliguar të vërtetojë në mënyrë konkrete se ku dhe si është përmbushur kërkesa për garancion/autorizim/konfirmim nga prodhuesi për lotin konkret. Një arsyetim i përgjithshëm mbi përkatësinë e OKTA-s në grupin HELLENiQ ENERGY nuk është i mjaftueshëm.

Duke pasur parasysh se oferta e Grupit tonë ka qenë oferta me çmimin më të ulët për Lotin 4 dhe Lotin 9, me një diferencë të përgjithshme prej 122,099.47 €, është veçanërisht e rëndësishme që vlerësimi i ofertave të jetë bërë mbi bazën e të njëjtave kërkesa dhe me të njëjtin standard për të gjithë operatorët ekonomikë.

Për këto arsye, mbetemi pranë të gjitha pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe kërkojmë që vendimi i AK-AQP-së për refuzimin e saj të rishikohet dhe të korrigjohet, si dhe të bëhet rivlerësimi i ofertave në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, LPP-në dhe parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

PËRFUNDIM

Nga të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura rezulton se: Oferta e Grupit të OE “LAB OIL” Sh.p.k. & N.T “Fer Petroll” Sh.p.k. është eliminuar duke u bazuar në një interpretim strikt të kërkesës së Dosjes së Tenderit. I njëjti standard nuk është zbatuar ndaj OE “Petroll Company” SH.P.K. dhe “EX FIS” Sh.P.K. Dokumentet e paraqitura nga OE i rekomanduar nuk dëshmojnë përmbushjen e kërkesës: “Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhuesi – rafineria që garanton furnizimin për kontratën.”

Pranimi i një oferte më të shtrenjtë, pa përmbushje të qartë të kërkesave të tenderit, cenon interesin publik dhe parimet e prokurimit publik.

VENDIM PËRFUNDIMI

Duke u bazuar në të gjitha arsyet e cekura më lart, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues – AQP/Zyra e Prokurimit që:

1. Ta aprovojë si të bazuar Ankese e Grupit të OE "LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k.
2. Të anulojë Vendimin për eliminimin e ofertës së Grupit të Operatorëve Ekonomik "LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k.;
3. Të anulojë rekomandimin për dhënie të kontratës ndaj operatorit ekonomik "Petroll Company" Sh.P.K.;
4. Të bëjë rivlerësimin e ofertave duke zbatuar në mënyrë të njëjtë kriteret e Dosjes së Tenderit ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë;
5. Pas rivlerësimit, të rekomandojë për dhënie të kontratës Grupin e Operatorëve Ekonomik "LAB OIL" Sh.p.k. & N.T "Fer Petroll" Sh.p.k., si operator ekonomik që përmbush kërkesat e tenderit dhe ka paraqitur ofertën ekonomikisht më të favorshme.
6. Të sigurojë zhvillimin e një procedure të drejtë, transparente dhe në përputhje me dispozitat e LPP-së.

8. Dëmet materiale

Përshtet mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si OE na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesës për Rishqyrtim dhe Ankeses 500.00 euro, si dhe fitimi i pa realizuar lidhur me këtë kontratë në shumen 250,000.00 euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.